

Jonild Hoxhaj, është Kryeauditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Departamenti i Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Investimeve të Huaja dhe e ushtron këtë pozicion që prej shkurtit të vitit 2018. Prej vitit 2014 nisi punën si auditues në KLSH.

z. Hoxhaj ka përfunduar studimet në vitin 2010 në Universitetin Politeknik Tiranë, Fakultetit i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Inxhinieri Ndërtimi dhe në vitin 2017 ka përfunduar studimet në nivelin Master Profesional, dega Financë Kontabilitet.

Ai është certifikuar në Kursin të Auditimit të Energjisë në vitin 2017 dhe si Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme në vitin 2016.

Në vitin 2016 ka marrë pjesë në një Program Trajnimi Internship të mundësuar nga Gjykata Evropiane e Auditimit (ECA) në Luksemburg, ku ishte pjesë e Departamentit të Investimeve për Kohezionin, Rritjen dhe Përfshirjen duke dhënë kontribut në draft raportin final të auditimit për vitin financiar 2015, një propozimi konkret për auditimin e projekteve për Energjinë e Rinovueshme nga Fondet Evropiane për Zhvillimin e Rajoneve si dhe duke u angazhuar si anëtar grupi në auditimin e bërë sipas programit *Calabria FESR – 2007 – 2013*.

Mbështetur në eksperiencës audituese, ka dhënë një kontribut të vlefshëm edhe në botimet në median e shkruar nga stafi i KLSH, me shkrime si:

Dritëhijet e investimeve të reklamuar si sukses – viti 2020;

Investimet publike dhe (dis)favoret e korrupsionit – viti 2020

Pandëshkueshmëria në administratë krijon pasoja me shkelje ligjore – viti 2016

Investimet publike dhe problematikat që i shoqërojnë ato – viti 2016

Bashkëveprimi KLSH – Media, një përjasje mes Institucionit dhe publikut – viti 2015

z. Hoxhaj ka ushtruar profesionin e vet si inxhinier në Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit e Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) për gati 3 vite 2009 – 2012 dhe më pas për një periudhë 2 vjeçare 2012 – 2014 në një subjekt privat në fushën e ndërtimit.

Z. Hoxhaj është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.